

## TESTET DIAGNOSTIKE DHE PROCEDURAT LABORATORIKE

1. Një infermier po kujdeset për një pacient hipoglicemik. Pacienti do të ketë nivelin e glukozës:
  - a. Më pak se sa 70 mg/dl
  - b. Ndërmjet 70 – 120 mg/dl
  - c. Ndërmjet 120-180 mg/dl
  - d. Më shumë se sa 180 mg/dl
  
2. Për të vlerësuar hypoxinë mjeku ka më shumë mundësi që të përshkruajë cilin nga testet laboratorike?
  - a. Numrin e Eritrociteve
  - b. Kulturën e sekrecioneve
  - c. Hemoglobin totale
  - d. Analizën e gazeve arteriale në gjak
  
3. Një klient ndihet nervoz rreth procedurës së Rezonancës Manjetike (MRI) që do të kryejë. Cila thënie e infermierit do të sigurojë më shumë pacientin rreth procedurës?
  - a. “Është e nevojshme që të hiqen të gjitha objektet prej metali përpara se të kryet procedura për të shmangur futjen e metaleve në fushën manjetike.”
  - b. “MRI është një pajisje e gjatë në formë tubi që ju bën të ndiheni klaustrofobik.”
  - c. “Edhe pse ju jeni vetëm në skaner, një teknik do të komunikojë me ju gjatë gjithë kohës së procedurës.”
  - d. “Ju do të ushqeheni përpara procedurës vetëm në rast se nuk ndjeni nausea me lehtësi.”
  
4. Infermieri po performon check-upin tek një pacient 54 vjeç. Pacienti e ka presionin e gjakut 128/82, kolesterolin total 190mg/dl, nivelin e glukozës 184 mg/dl. Infermieri interpreton rezultatin se pacienti ka një rrezik të modifikueshëm për sëmundje koronare të zemrës?
  - a. Hipertension
  - b. Intolerancë nga glukozja
  - c. Moshja
  - d. Hiperlipidemia
  
5. Mjeku ka kërkuar një ekocardiogram (Eko për pacientin. Cilin veprim do të ndërmarë infermieri për të përgatitur pacientin për këtë procedurë?
  - a. Infermieri pyet pacientin rreth alergjisë nga Jodi ose peshku
  - b. Infermieri mban pacientin 2 orë pa ushqyer përpara procedurës
  - c. Infermierja i thotë pacientit se procedura është pa dhimbje dhe zgjat 30-60 min.
  - d. Infermieri i jep pacientit që të firmosë konsentin e një procedure invasive

6. Një pacient me sëmundje të arterieve koronare është planifikuar për të kryer testin e stresit. Infermieri planifikon të japë, cilin nga shpjegimet e më poshtme rreth kësaj procedure?
- Shmang pirjen e cigareve 30 min përpara procedurës
  - Vish rroba të lira me kopsa përpara
  - Ha mëngjes përpara procedurës
  - Vish këpucë të forta si këpucët e punës
7. Pacienti do të kryejë kataterizimin kardiak. Infermieri i jep prioritet mësimin të pacientit rreth *raportimit të menjëhershëm* të cilës ndjenjë gjatë procedurës?
- Presion në vëndin e hyrjes
  - Nevoja për t'u kollur
  - Ndjenjen e të ngrohtit dhe skuqjes
  - Dhimbje gjoksi
8. Një paciente rrezikon për shfaqjen e Koagulimit Intravasular të Diseminuar. Infermieri shikon rezultatet laboratorike dhe përcakton se niveli normal i fibrinogjenit është në cilën nga raportimet e mëposhtme?
- 180mg/dl
  - 400mg/dl
  - 480mg/dl
  - 500mg/dl
9. Një pacient me histori sëmundje kardiake do të marrë dozën e mëngjesit të Lasiksit. Infermieri planifikon të raportojë cilin nga *nivelet e kaliumit* përpara se të administrojë dozën e Lasiksit?
- 3.8mEq/l
  - 3.2mEq/l
  - 4.8mEq/l
  - 4.2mEq/l
10. Një i ri 22 vjeç ka kryer testin e kolesterolit në ambulancë. Një infermiere po i mëson klientët që ushtrimet dhe dieta duhet të fillohen për të mbajtur nivelin e kolesterolit nën:
- 140mgdl
  - 200mgdl
  - 250mgdl
  - 300mgdl
11. Një infermiere në urgjencë po shikon testet laboratorike të një pacienti që dyshohet për ketoacidozë diabetike. Cila nga rezultatet do të ndihmojë infermierin rreth problemit?

- a. Mungesa e ketoneve në urinë
  - b. Niveli i glukozës 500mgdl
  - c. pH i gjakut venoz 8
  - d. Niveli I serumi bikarbonat 22 mEq/l
12. Një infermier po i jep instruksione një pacienti që është planifikuar për enema me barium. Infermieri mëson pacientin se:
- a. Një dietë me pak fibra duhet të mbahet për 1-3 ditë përpara testit
  - b. 4 ditë përpara testit pacienti duhet të mbajë një dietë më lëngje të qarta
  - c. Laksativët nuk duhet të merren 1 javë përpara testit
  - d. Lëngjet kufizohen 24 orë përpara testit
13. Një infermiere po planifikon një pacient për biopsy të mëlçisë. Infermieri shikon analizat dhe shpreson të gjejë cilin rezultat laboratorik të dokumentuar në kartelë përpara procedurës.
- a. Kohën e protombinës
  - b. Nivelin e Leukociteve
  - c. Azotemia
  - d. Nivelin e acidit urik
14. Një infermier po shikon rezultatet e analizave të një pacienti që dyshohet për hepatit. Infermieri interpreton rritjen e cilës nga analizat si tregues specifik të sëmundjes?
- a. Sendimenti eritrocitar
  - b. Niveli i bilirubinës
  - c. Hemoglobina
  - d. Azoti
15. Një pacient i rritur ka histori të gjakrrjedhjes gastro intestinale. Numri i trombocideve është 300,000 cel/ml. Cili do të ishte veprimi më i përshtatshëm infermieror pas marrjes së këtij rezultati?
- a. Raporto nivelin e ulur
  - b. Raporto nivelin e lartë
  - c. Vendos pacientin në parandalim gjakrrjedhjeve
  - d. Vendos rezultatin normal në kartelën e pacientit
16. Një pacient me Cirozë Hepatike ka ndjekur një dietë me sasi të shtuar protein, sepse ka pasur defiçens të proteinës. Dieta ka qënë e suksesshme. Infermieri vlerëson statusin e pacientit si më të kënaqshëm nëse niveli i proteinës totale do të ishte brënda normave normale:
- a. 0.4g/dl
  - b. 3.7g/dl

- c. 6.4g/dl
- d. 9.8g/dl

17. Një infermier po përgatitet që t'i heqë tubin nazogastrik një pacienti. Infermieri mëson pacientin që të kryejë cilin nga veprimet e mëposhtme përpara se ajo të tërheqë tubin NG:

- a. Të kryejë Valsava Manover
- b. Të marrë frymë thellë dhe ta mbajë
- c. Të nxjerrë frymën
- d. Të inhale dhe exhale me shpejtësi

18. Një pacient është planifikuar për një egzaminim GI me barium për ditën tjetër. Infermieri rekomandon cilën përgatitje përpara testit?

- a. 8 orë pa ngrënë përpara testit
- b. Ushqehu rregulisht
- c. Vazhdo të marrësh medikamentet orale sipas planifikimit
- d. Monitoro të dalat jashtë për konstipacion

19. Një infermier po jep këshilla një pacienti që është planifikuar për cholecystogram orale. Infermierja i thotë klientit të:

- a. Marrë një dietë yndyrore një natë përpara procedurës
- b. Qëndrojë pa ngrënë një ditë përpara procedurës
- c. Të shmangë marrjet orale përveç ujit një ditë përpara procedurës
- d. Marrë një vakt me yndyrë të shtuar në mëngjesin e ditës së procedurës

20. Një infermier po shikon testin diagnostik të një pacienti me çrregullime të indit konektiv. Eritrocentrimenti është 100mm/orë. Infermieri e interpreton këtë gjetje si:

- a. Normal
- b. Tregon inflamacion të lehtë
- c. Tregon inflamacion të moderuar
- d. Tregon inflamacion të avancuar

21. Një pacient është planifikuar për të kryer biopsi të lëkurës. Ai është i shqetësuar dhe pyet infermierin se sa e dhimbshme është procedura? Përgjigjja më e përshtatshme e infermierit do të jetë:

- a. Kjo procedurë nuk shoqërohet me dhimbje
- b. Do të ndiesh pak dhimbje por mjeku do të përshkruajë një analgjezik pas procedurës
- c. Mjeku do të përdorë anestetik lokal që shkakton një ndjejnë si djegie ose çpim
- d. Mjekime paraoperative do t'ju jepen dhe ju do të jeni në gjumë gjatë gjithë kohës dhe nuk do të ndjeni dhimbje